



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 6272 Prot.

Tiranë, më 01.08.2014
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA: MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 539 ,DATË 6.8.2014 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR HEQJEN E LIÇENCËS DISA INSTITUCIONEVE PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË” DHE UDHËZIMIT NR. 25, DATË 11.08.2014, TË MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SPORTIT “PËR PROCEDURAT QË DO TË NDIQEN PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT TË TRANSFERIMIT TË STUDENTËVE NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË TË CILËVE IU ËSHTË HEQUR LICENCA”

DREJTUAR: Z. PIRO CIPO
REKTOR I INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË “VITRINA”
PRANË “CITY PARK”, GJOKAJ, VORË
TIRANË

TIRANË

I nderuar z. Cipo,

Pranë ministrisë së Arsimit dhe Sportit po depozitohen një sërë ankesash lidhur me pagesat që u kërkohen studentëve nga ana e institucionit të arsimit të lartë privat “Vitrina” lidhur me dorëzimin e dosjes së studentit në zbatim të Vendimin nr. 539 ,datë 6.8.2014 të Këshillit të Ministrave “Për heqjen e liçencës disa institucioneve private të arsimit të lartë” dhe Udhëzimit nr. 25, datë 11.08.2014, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat që do të ndiqen për organizimin e procesit të transferimit të studentëve nga institucionet e arsimit të lartë të cilëve iu është hequr licenca”. Konstatojmë se ky problem paraqitet vetëm për studentët e institucionit që ju drejtoni. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimin e sipërcituar është parashikuar vënia në dispozicion të çdo studenti e dosjes, sipas parashikimit në këto akte, pa asnjë pagesë nga ana e studentit. Për sa më sipër, gjykojmë se institucioni që ju përfaqësoni, si dhe ju si drejtues i tij, jeni në shkelje të hapur të akteve nënligjore të sipërpërmendura.

Për sa më sipër kërkohet nga ju marrja e të gjitha masave për:

1. Vënie në dispozicion të dosjeve të plota sipas parashikimeve në aktet ligjore të sipërpërmendura çdo studenti brenda datës 1 shtator pa i kërkuar asnjë lloj pagese suplementare;

2. Rimbursimin e studentëve me vlerat monetare të përfituara prej tyre për tërheqjen e dosjeve.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, IAL-së "Vitrina" i është hequr liçenca me Vendimin nr. 539 ,datë 6.8.2014 të Këshillit të Ministrave "Për heqjen e liçencës disa institucioneve private të arsimit të lartë". Për sa më sipër, institucioni që ju drejtoni është i detyruar, përveçse t'i vërë në dispozicion studentëve dosjet e tyre, sipas parashikimeve në aktet e sipërcituara dhe pa asnjë lloj pagese suplementare, brenda datës 1 shtator 2014, edhe t'i rimbursojë studentët për të gjitha pagesat e kryera nga studentët për të cilat ata nuk kanë marrë shërbimin për të cilin kanë paguar.

Dosjet e studentëve, të përgatitura nga institucioni juaj që nuk do të tërhiqen nga studentët përkatës, dorëzohen zyrtarisht në protokollin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nga data 2 deri në datën 10 Shtator 2014, ashtu si dhe i gjithë dokumentacioni ligjor, administrativ, financiar dhe akademik që disponon institucioni dhe mbi bazën e të cilit ka zhvilluar veprimtarinë e tij akademike, që prej fillimit të veprimtarisë.

Ju bëjme me dije, gjithashtu, se Ministria e Arsimit dhe Sportit do të mbështesë çdo student të cilit do t'i shkelet e drejta nga ana e çdo institucioni të arsimit të lartë privat, për të kërkuar të drejtën e tij në rrugë gjyqësore, dhe do të kërkojë vënien para organeve të drejtësisë të të gjithë përgjegjësve për moszbatimin e kuadrit ligjor në fuqi.

Besojmë se sa më sipër ju sqaron dhe lidhur me shkresën tuaj nr. 6128 prot. datë 21.08.2014, edhe pse gjykojmë se procedurat janë të përshkruara qartësisht në aktet përkatëse të sipërcituara.

LINDITA NIKOLLA



MINISTËR

